



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE**

Nr. 913/9 prot.

Tiranë, më 15.06.2026

VENDIM

Nr. 21, datë 15.06.2026

**PËR
URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Health and Light sh.p.k, përfaqësuar nga z. (në vijim “ankuesi”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 913 prot., datë 31.03.2026, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoriteteve Publike “Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a. dhe Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, (në vijim “Autoritetet Publike”, O.B.P sh.a. dhe Q.S.U.N.T).

Ankuesi, nëpërmjet kërkesave për informacion datë 09.03.2026, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me procedurën e prokurimit me nr. REF-72884-12-18-2025, me objekt: “Blerje pajisje mjekësore CT Skanner për Shërbimin e Urgjencave Polivalente”. Konkretisht:

1. *Një kopje të trajtimit të ankesës nga autoriteti kontraktor;*
2. *Të gjithë praktikën përkatëse shkresore ndërmjet O.B.P. sh. a. dhe Q.S.U. “Nënë Tereza”;*
3. *Kopje të Grupit të Punës/urdhrit për hartimin e specifikimeve teknike.*

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, pasi nuk ka marrë përgjigje nga Autoritetet Publike, ankuesi i është drejtuar Komisionerit me ankesë, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, Komisioneri, me shkresën nr. 913/1 prot., datë 21.04.2026, ka kërkuar nga Autoritetet Publike të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e informacionit/dokumentacionit të kërkuar, duke mbajtur në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të LDI, ku përcaktohet se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarës. Autoritetet Publike tregojnë qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 2020/1 prot., datë 24.04.2026, regjistruar pranë Komisionerit me nr. 913/2 prot., datë 27.04.2026, ka kthyer përgjigje duke informuar se: *“...më datë 19.12.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik procedura e prokurimit me numër reference REF-72884-12-18-2025, me objekt “Blerje pajisje mjekësore CT Skanner për Shërbimin e Urgjencave Polivalente”, me fond limit 67,142,800 (gjashtëdhjetë e shtatë milion e njëqind e dyzetë e dy mijë e tetëqind) lekë pa TVSH...Gjatë afatit për pritjen e ofertave janë administruar ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë “Health & Light” sh.p.k., me NIPT L 42231011 L, paraqitur përmes Sistemit të Ankesave Elektronike me nr. aplikimi A/2025/6214;... Gjatë shqyrtimit të ankesave, operatori ekonomik “Health & Light” sh.p.k. ka kërkuar informacion nëpërmjet shkresës me nr. 798 prot., datë 18.02.2026. Në vijim të kësaj kërkesë, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a., ka kthyer përgjigje lidhur me pretendimet e ngritura, me shkresën nr. 798/1 prot., datë 19.02.2026. Më pas, operatori ekonomik “Health & Light” sh.p.k. ka ridërguar sërish kërkesë për informacion me shkresën nr. 798/2 prot., datë 24.02.2026, ndaj së cilës Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a. ka bërë kthim përgjigje me shkresën nr. 798/3 prot., datë 25.02.2026, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe brenda kufijve të kompetencave të tij ligjore. Në vijim, lidhur me objektin konkret të kërkesës për informacion, sqarojmë se operatori ekonomik “Health & Light” sh.p.k., ka paraqitur pretendime dhe kërkesa për dokumentacion që lidhen me akte, dokumente dhe elemente të hartuara apo të administruara nga autoriteti përfitues, konkretisht Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, dhe jo me dokumente apo akte administrative të nxjerra nga vetë Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a. Në këtë kuptim, dokumentacioni i kërkuar nuk përbën dokumentacion të hartuar nga vetë O.B.P. sh.a., por lidhet me dokumentacion teknik/shkresor, me procesin e hartimit të specifikimeve teknike, me grupin e punës dhe me akte apo dokumente të brendshme të institucionit përfitues. Si rrjedhojë, ky dokumentacion nuk klasifikohet si dokumentacion apo akt administrativ i nxjerrë nga vetë Operatori Blerjeve të Përqendruara sh.a., por si dokumentacion që i përket institucionit që e ka hartuar, prodhuar dhe administruar atë. Referuar rolit funksional dhe*

kompetencave ligjore të Operatorit të Blerjeve të Përqendruara sh.a, ky i fundit administron dokumentacionin procedural në kuadër të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, por nuk është organi hartues i specifikimeve teknike, i urdhrave për ngritjen e grupeve të punës, apo i akteve të tjera të brendshme administrative që lidhen me institucionin përfitues. Hartimi i specifikimeve teknike, përcaktimi i kërkesave funksionale dhe teknike, si dhe administrimi i dokumentacionit të brendshëm përkatës, janë kompetencë dhe përgjegjësi e institucionit që i ka prodhuar ose i mban në administrim.”

Ndërkohë, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 1748/3 prot., datë 07.05.2026, regjistruar pranë Komisionerit me nr. 913/3 prot., datë 08.05.2026 duke sqaruar ndër të tjera se, “...Nga shqyrtimi i kësaj shkrese rezulton se shoqëria “Health & Light” sh.p.k. (në vijim “OE”) ka paraqitur ankim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit, lidhur me pretendimin për refuzim të dhënies së informacionit në kuadër të procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje pajisje mjekësore CT Skanner për Shërbimin e Urgjencës Polivalente”, REF-72884-12-18-2025, në vijim të kërkesës për informacion të paraqitur prej tij pranë QSUT më datë 09.03.2026. Në këtë kuadër, kërkohet informacion nga Q.S.U.T mbi mënyrën e trajtimit të kërkesave për informacion të paraqitura nga O.E. ...QSUT me shkresën nr. 690/l prot., datë 10.02.2026, ka sqaruar operatorin ekonomik se, referuar përcaktimeve të legjislacionit të prokurimit publik si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, duke qenë se procedurat e prokurimit referuar VKM nr. 531, datë 07.09.2023, “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sh.a., për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit, në emër dhe për llogari të kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë, ngarkon Operatorin Blerjeve të Përqendruara (OBP) që në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, të zhvillojë procedura prokurimi për të tretë, përfshirë Q.S.U.N.T., duke e orientuar që për çdo pretendim lidhur me procedurën e prokurimit dhe trajtimin e ankesave, duhet t’i drejtohet organit kompetent, konkretisht O.B.P. Gjithashtu, O.E. ka paraqitur pranë Q.S.U.T. kërkesë me datë 19.03.2026, ku ka kërkuar ndër të tjera: “Vënien në dispozicion të një kopje të ankesës së trajtuar nga autoriteti kontraktor për këtë procedurë prokurimi, praktikën shkrese ndërmjet O.B.P. dhe Q.S.U.T., përfshirë edhe një kopje të grupit të punës, urdhrin për hartimin e specifikimeve teknike nga ana e Q.S.U.T., pasi kemi dyshime të arsyeshme se personat që kanë shqyrtuar ankesën lidhur me specifikimet teknike nga Q.S.U.T., janë emëruar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 73/3 të VKM nr. 285/2021, i ndryshuar, nisjen e hetimit administrativ për këtë dyshim, i cili nëse vërtetohet do të çonte në pavlefshmërinë e procedurës së prokurimit. ...Procedura e sipërcituar e prokurimit publik është zhvilluar nga Operatori i Blerjeve të Përqendruara (në vijim “OBP”), në cilësinë e Organit Qendror Blerës, në përputhje me V.K.M. nr. 531/2023, i ndryshuar. Për efekt të qartësimit të kuadrit të kompetencave institucionale, parashtrojmë ndarjen përkatëse ndërmjet institucioneve të përfshira në këtë procedurë: O.B.P., është institucioni përgjegjës në cilësinë e autoritetit kontraktor (AK) për zhvillimin e plotë të procedurës së prokurimit, duke përfshirë publikimin e saj, ngritjen e strukturave përkatëse që i takon zhvillimit të procedurës së prokurimit: Njësinë e Prokurimit Publik, Komisionin e Vlerësimit të Ofertave, si dhe trajtimin e ankesave të

paraqitura (Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave për dokumentet e tenderit apo procesin e vlerësimit të ofertave) nga operatorët ekonomik në kuadër të procedurave të prokurimit publik... Q.S.U.T., në cilësinë e institucionit përfitues, ka rol teknik dhe ndjek procesin e hartimit të specifikimeve teknike, rishikimin e tyre, si dhe përllogaritjen e vlerësimit të procedurës së prokurimit publik, nëpërmjet grupit të posaçëm të punës të ngritur për këtë qëllim. Në këtë kuadër, Q.S.U.T. nuk ka pasur rol vendimmarrës në zhvillimin e procedurës së prokurimit, në vlerësimin e ofertave apo në shqyrtimin e ankesave të operatorëve ekonomik. Për rrjedhojë, trajtimi i ankesave administrative nuk përfshihet në kompetencën institucionale të Q.S.U.T., por realizohet nga O.B.P. në cilësinë e Organit Qendror Blerës dhe autoritetit kontraktor dhe, më tej, nga Komisioni i Prokurimit Publik, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik. Së dyti, në lidhje me pretendimin se, përbërjen e grupit të punës për hartimin/rishikimin specifikimeve teknike është ngritur në kundërshtim me parashikimin e nenit 73/3 i VKM nr. 285/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sqarojmë se: Në nenin 73/3 të VKM nr.285/2021, i ndryshuar, parashikohet se: “Titullari i autoritetit kontraktor duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit. Në çdo rast titullari i autoritetit/entit kontraktor duhet të sigurohet që zyrtarët/nëpunësit e prokurimit të jenë pjesë në vetëm një prej grupeve të punës që do të merren me procesin e prokurimit deri në shpalljen e fituesit pas përfundimit të afateve të ankimit.” Në kuptim të kësaj dispozite, kërkohet një ndarje e qartë dhe efektive ndërmjet strukturave të përfshira në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshira në procesin e vlerësimit të ofertave apo trajtimit të ankesave, me qëllim garantimin e paanshmërisë dhe integritetit të procedurës së prokurimit publik, proces i cili fillon nga momenti procedural i daljes së Urdhrit të Prokurimit. Në zbatim të kësaj dispozite, sqarojmë se grupi i punës për hartimin dhe rishikimin e specifikimeve teknike është krijuar nga QSUT dhe përbëhet nga punonjës të këtij institucioni, të cilët kanë ushtruar vetëm funksione teknike në kuadër të procedurës së prokurimit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, ndërkohë, strukturat përgjegjëse për zhvillimin e procedurës së prokurimit, përfshirë Njësinë e Prokurimit, Komisionin e Vlerësimit të Ofertave dhe Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave, janë ngritur nga OBP, në cilësinë e autoritetit kontraktor. Këto struktura nuk kanë pasur në përbërje anëtarë të emëruar nga QSUT. Gjithashtu, OBP, me shkresën nr. 4146/9 prot., datë 31.12.2025, administruar në QSUT më datë 05.01.2026, ka kërkuar rishikimin e specifikimeve teknike sipas konstatimeve të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, për të cilën QSUT me shkresën nr. 2/1 prot., datë 04.02.2026, ka përcjellë pranë OBP relacionin përkatës mbi rishikimin e specifikimeve teknike. Më tej, sikurse jeni në dijeni, OE Health & Light ka paraqitur ankesë mbi Dokumentet e Tenderit (DST) për këtë objekt, për të cilën Komisioni i Prokurimit Publik, ka disponuar me vendimin nr. 294/2026, datë 23.02.2026, duke vendosur mospranimin e kërkesave për disa pika, si dhe rishikimin e specifikimeve teknike të procedurës së prokurimit. Në zbatim të këtij vendimi, OBP, me shkresën nr. 2/3 prot., datë 02.03.2026, ka kërkuar nga QSUT rishikimin e mëtejshëm të specifikimeve teknike. Në zbatim të kërkesës së sipërcituar, QSUT, me shkresën nr. 2/11 prot., datë 23.04.2026, ka përcjellë pranë OBP relacionin përfundimtar të grupit të punës për rishikimin e specifikimeve teknike. Në këtë kuadër, rezulton se përfshirja e QSUT në procedurën e sipërcituar të prokurimit ka qenë e

kufizuar ekskluzivisht në aspektin teknik të hartimit dhe rishikimit të specifikimeve teknike sipas nevojave minimale të cilat duhet të plotësojë pajisja e kërkuar, ndërsa procesi i vlerësimit të ofertave dhe shqyrtimit të ankesave është zhvilluar nga strukturat kompetente të OBP, në cilësinë e autoritetit kontraktor si dhe KPP si organi më i lartë administrativ që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit publik. Së treti, lidhur me kërkesën për vënien në dispozicion të një kopje të grupit të punës/urdhrit për hartimin e specifikimeve teknike nga ana e QSUT, sqarojmë se: Në shkresën e administruar me nr. 1141 prot., datë 09.03.2026, shprehimisht kërkohet që: nga AK, OBP sh.a. nëpërmjet stafit të QSUT, të shoqëruar me të gjithë praktikën përkatëse shkresore ndërmjet OBP sh.a., dhe QSUT, si dhe kopje të grupit të punës/urdhrit për hartimin e specifikimeve teknike nga ana e QSUT. Pra nga sa konstatohet, ky dokumentacion i është kërkuar Autoritetit Kontraktor i cili për rastin në fjalë është OBP. Gjithsesi pavarësisht faktit se kërkesa i është drejtuar Autoritetit Kontraktor, QSUT vlerëson se kërkesa duhet të analizohet në raport me parimin e proporcionalitetit, si dhe me nevojën për të garantuar balancën ndërmjet së drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale dhe interesave legjitime të punonjësve publikë. Në rastin konkret, QSUT vlerëson se vënia në dispozicion e anëtarëve të grupit të punës nuk është i nevojshëm dhe i domosdoshëm për realizimin e qëllimit të transparencës publike në kuptim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, për sa kohë që të gjithë anëtarët e këtij grupi kanë ushtruar funksionin e tyre në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, si dhe kanë përmbushur detyrimet ligjore për deklarimin e konfliktit të interesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Anëtarët e grupit të punës janë edhe specialistë të fushës, të cilët angazhohen në mënyrë të vazhdueshme në procese të hartimit dhe rishikimit të specifikimeve teknike për procedura të ndryshme prokurimi publik pranë QSUT. Në këto rrethana, ekspozimi i identitetit të tyre krijon një rrezik të arsyeshëm për ushtrimin e presioneve, ndikimeve apo ndërhyrjeve të paligjshme nga subjekte të tretë, dhe mund të cenojë integritetin e procesit administrativ të prokurimit publik, si dhe ushtrimin e pavarur dhe të paanshëm të funksioneve të tyre institucionale. Së katërti, lidhur me kërkesën për nisjen e hetimit administrativ në kuadër të procedurës së sipërcituar të prokurimit, sqarojmë se, në nenin 129 të ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, kompetenca për kryerjen e hetimit administrativ i përket Agjencisë së Prokurimit Publik, e cila është shprehur me shkresën nr. 2015/1 prot., datë 13.03.2026. Për rrjedhojë, QSUT nuk ka kompetencë ligjore për fillimin apo zhvillimin e hetimeve administrative në lidhje me procedurat e prokurimit publik sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik. Sikurse u citua me sipër, roli i QSUT është kufizuar ekskluzivisht në aspektin teknik të hartimit dhe rishikimit të specifikimeve teknike, në përputhje me kërkesat e OBP dhe në zbatim të vendimit të sipërcituar të KPP, në proporcion me nevojat e furnizimit të QSUT, pa marrë pjesë në procesin e vlerësimit të ofertave apo në shqyrtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë. QSUT mbetet e angazhuar në përmbushjen e plotë dhe në kohë të detyrimeve të saj ligjore, si dhe mbetemi në dispozicion për çdo informacion apo sqarim të mëtejshëm që mund të nevojitet, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kompetencat institucionale të QSUT.

Pas përgjigjeve të sipërcituara, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, në të

cilin parashikohet se: *”...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”*, bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri çmoi të nevojshme zhvillimin e një seance dëgjimore, e cila u zhvillua më datë 20.05.2026 me praninë e përfaqësuesve të ankuesit dhe përfaqësuesve të Autoriteteve Publike. Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesit e ankuesit dhe përfaqësuesit e Autoriteteve Publike rikonfirmuan qëndrimet e reflektuara në aktet shkresore të sipërcituara.

Sa i takon kërkesës për vendosje në dispozicion të kopjes së trajtimit të ankesës nga autoriteti kontraktor, gjatë seancës dëgjimore u qartësuan kompetencat e secilit autoritet dhe nga ana e Autoriteteve Publike u informua ankuesi se shqyrtimi i ankesës është kryer nga O.B.P sh.a përmes vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës nr. 17/2026, i cili i është përcjellë ankuesit. Gjithashtu, një kopje e këtij vendimi iu vu në dispozicion ankuesit gjatë seancës dëgjimore.

Pas përfundimit të seancës dëgjimore, me e-mailin e datës 20.05.2026, ky autoritet ka përcjellë pranë Komisionerit vendimin e sipërcituar, i cili rezulton të jetë përcjellë me shkresën nr. 4146/12 prot., datë 05.02.2026 si dhe foto të faqes web (printscreen) të KPP dhe kopje të librit të dorëzimit të postës si provë e dërgimit në të dyja format e deklaruara në seancë, në adresat e ankuesit, në kundërshtim me deklaratën e këtij të fundit për mosvënien në dijeni të këtij dokumenti. Në këtë kuptim, kërkesa për informacion sipas pikës 1 konsiderohet e përmbushur nga ana e O.B.P sh.a.

Sa i takon dokumentacionit në lidhje me të gjithë praktikën përkatëse shkresore ndërmjet O.B.P. sh. a. dhe Q.S.U.N.T, gjatë seancës, ashtu edhe në shkresat për kthim përgjigje të Q.S.U.N.T. është konfirmuar ekzistenca e praktikave përkatëse shkresore të shkëmbyera ndërmjet O.B.P. sh.a. dhe Q.S.U.N.T., në kuadër të shqyrtimit të ankesës që ankuesi ka bërë pranë O.B.P. sh.a. Në vijim të seancës dëgjimore me shkresën me nr. 01.06.2026, ankuesi ka kërkuar vendosjen në dispozicion të këtij dokumentacioni nga ana e Q.S.U.N.T.

Në lidhje me këtë dokumentacion pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, parashtrimeve të paraqitura nga Autoritetet Publike dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Q.S.U.N.T, nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”*. Në kuptim të këtij parashikimi, O.B.P sh.a dhe Q.S.U.N.T janë Autoritete Publike dhe subjekte të LDI, për rrjedhojë detyrohen për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundur realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga*

autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.”

Thënë kjo, vlen të theksojmë se LDI, edhe pse jo shprehimisht, bën një kategorizim të informacionit të aksesueshëm nga publiku në dy kategori kryesore: 1) *informacioni që bëhet publik pa kërkesë* dhe 2) *informacioni që vihet në dispozicion pas kërkesës së subjektit të interesuar*. Në kategorinë e parë, përfshihen ato kategori informacioni, përcaktuar në nenin 7 të LDI, të cilat publikohen dhe vihen në dispozicion nga Autoritetet Publike, pa qenë i nevojshëm angazhimi i ndonjë subjekti, ndërsa rasti konkret objekt shqyrtimi, i përket kategorisë së dytë, që përfshin ato informacione për njohjen e të cilave është e nevojshme të paraqitet një kërkesë për informim pranë Autoritetit Publik, në përputhje me parashikimet e nenit 11 e vijues të LDI, detyrim të cilin Q.S.U.N.T nuk e ka përmbushur.

Fryma e përgjithshme e LDI, si dhe e ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, është të sigurojë integritet, besim në publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik, nga ana e Autoriteteve Publike, duke bërë publike sa më tepër informacion që lidhet me këto procedura dhe jo duke e kufizuar atë. Vetë ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në nenin 2 të tij përcakton se një nga qëllimet e tij është që të sigurojë transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ndërkohë, në nenin 3 mbi parimet e përgjithshme të tij parashikohet që, ndër të tjera, autoritetet dhe entet kontraktore veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. Edhe neni 18 parashikon në pikën 1 të tij se prokurimi publik duhet të zhvillohet në mënyrë transparente me paanshmëri dhe pa asnjë trajtim preferencial.

Në këto rrethana, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se informacioni/dokumentacioni i kërkuar, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2 të LDI, sipas të cilit “*Informacion publik*” konsiderohet *çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik*”. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, në rastit konkret Q.S.U.N.T, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, duke mbajtur në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të LDI, ku përcaktohet se: “*Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim*”.

Në lidhje me kërkesën për vendosjen në dispozicion të kopjes së Grupit të Punës/urdhrit për hartimin e specifikimeve teknike, fillimisht evidentohet se nga verifikimi i kërkesës për informacion dhe i parashtrimeve në seancë dëgjimore rezulton se ajo në thelb konsiston në marrjen e informacionit mbi emrat e anëtarëve të grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike.

Në vijim të seancës dëgjimore, me shkresën me nr. 1748/9 prot. datë 29.05.2026 Q.S.U.N.T, ndër të tjera, shprehet se: *“...Së pesti, në zbatim të nenit 6, pika 2, të ligjit nr. 45/2022 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumente zyrtare”, autoriteti publik, edhe në rastet kur një pjesë e informacionit të përfshirë në një dokument zyrtar i nënshtrohet kufizimeve ligjore, detyrohet të garantojë aksesin në pjesën tjetër të dokumentit, duke hequr ose anonimizuar elementët që mbrohen nga legjislacioni në fuqi. Ky interpretim është në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe me detyrimin për të realizuar një balancë të drejtë ndërmjet së drejtës për informim dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të individëve. Në këtë kuptim, QSUNT vlerëson se dokumentacioni i kërkuar mund të vihet në dispozicion të kërkuarit, pas anonimizimit të të dhënave personale identifikuese të anëtarëve të grupit të punës, duke garantuar njëkohësisht transparencën administrative dhe respektimin e kërkesave të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Në këtë mënyrë, sigurohet aksesin në informacionin e kërkuar, në përputhje me qëllimin dhe parimet e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, pa cenuar të drejtat e subjekteve të të dhënave personale. Për sa më sipër, QSUT vlerëson se ka vepruar në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe kuadrin ligjor në fuqi për prokurimin publik, duke garantuar një balancë të drejtë ndërmjet parimit të transparencës, të drejtës për informim dhe mbrojtjes së interesave të ligjshëm publikë e privatë. QSUT mbetet e angazhuar në përmbushjen me korrektësi dhe në kohë të detyrimeve që burojnë nga kuadri ligjor në fuqi, si dhe në garantimin e standardeve të transparencës, ligjshmërisë dhe integritetit institucional në ushtrimin e veprimtarisë së saj administrative.”*

Fillimisht sillet në vëmendje se dokumentet që lidhen me organizimin dhe funksionimin e autoriteteve publike, përbëjnë informacion publik dhe, si rregull, janë të aksesueshme për çdo kërkuar. Gjithashtu, bazuar në nenin 7, pika 1, shkronja “d” të LDI dhe Urdhrit nr. 280 datë 30.12.2025 “Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Autoritetet Publike”, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, një pjesë e informacionit përfshihet në kategorinë e informacionit që vendoset në dispozicion të publikut pa kërkesë.

Konkretisht, dispozita e sipërcituar përcakton se: *“Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime”.*

Nga sa më sipër, për anëtarë të grupit të punës që janë subjekt i parashikimeve të mësipërme, Autoriteti Publik jo vetëm duhet të kishte vendosur në dispozicion informacionin e kërkuar, por në zbatim të nenit 7 të LDI, duhet që informacionin e kërkuar ta bëjë publik në mënyrë proaktive në programin institucional të transparencës.

Zyra e Komisionerit thekson se, LDI, ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike. Emrat e nëpunësve civilë të emëruar në pozicionet e tyre të përhershme të punës apo të caktuar si anëtarë të një grupi pune lidhen drejtpërdrejt me ushtrimin e funksioneve zyrtare dhe jo me sferën e jetës së tyre private. Prandaj, nëpunësit publikë, për shkak të natyrës së funksionit që ushtrojnë dhe rolit të tyre në shërbim të interesit publik, i nënshtrohen një niveli më të lartë transparence në lidhje me veprimtarinë e tyre zyrtare.

Në këtë kontekst, sjellim në vëmendje se, Zyra e Komisionerit ka krijuar një praktikë të konsoliduar përmes vendimmarrjeve për raste të ngjashme, ku emrat e nëpunësve civilë/zyrtarëve publik, qoftë në pozicionet e tyre të përhershme apo qoftë kur janë ngarkuar me detyra në organe kolegjiale, janë konsideruar informacion publik. Këto vendime janë të publikuara në faqen zyrtare, konkretisht në linkun <https://www.idp.al/vendime-ddi/>. Ndër to përmendim vendimet nr. 23, datë 13.04.2021; nr. 50, datë 17.11.2021; nr. 56, datë 01.12.2022; nr. 4, datë 17.03.2022, nr.19, datë 15.05.2023, nr. 1, datë 07.02.2025, nr. 17, datë 20.06.2025, etj.

Sa i përket argumenteve të Q.S.U.N.T mbi analizimin e kërkesës në raport me parimin e proporcionalitetit, nevojën për të garantuar balancën ndërmjet së drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale dhe interesave legjitime të punonjësve publikë theksojmë kjo analizë në rradhë të parë është kryer nga vetë legjislatori nëpërmjet legjislacionit në fuqi.

Si fillim, sillet në vëmendje dispozita kushtetuese e paragrafit të dytë të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë e cila parashikon se *“2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.”*. Në rastin në shqyrtim rezulton se kërkohet informacion mbi emrat e personave që ushtrojnë funksionet e tyre shtetërore në kuadër të një procedure prokurimi.

Nga ana tjetër, në kuptim të pikës 3 të nenit 5, të ligjit nr. 124/2024 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* (në vijim LMDP), e *dhënë personale është çdo informacion në lidhje me një subjekt të dhënash*”. Pika 23 e po të njëjtut nen përcakton se: *“Subjekt i të dhënave” është çdo person fizik i identifikuar ose i identifikueshëm. Një person është i identifikueshëm nëse mund të arrihet në identifikimin e tij, duke iu referuar drejtpërdrejt ose tërthorazi një apo disa faktorëve identifikues të veçantë, si: emri, numri i identifikimit, të dhënat për vendndodhjen, një identifikues në internet, ose një apo më shumë faktorëve specifikë, lidhur me identitetin e tij fizik, fiziologjik, identitetin gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror.*

Ndërkohë, në rastin konkret kërkohet informacion mbi emrat e anëtarëve të grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike në cilësinë e nëpunësve civilë/zyrtarëve publikë gjatë ushtrimit të detyrave/funksioneve të tyre. Për këtë situatë, LMDP përmban një parashikim të veçantë në pikën 2 e nenit 44 të tij ku parashikon se: *“Aksesi i publikut*

në informacionin publik, siç përcaktohet në ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, dhe aksesit i publikut në informacionin që lidhet me kryerjen e funksioneve dhe të detyrave zyrtare, nuk pengohet nga e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale të personave fizikë, të cilët konsiderohen si autoritete publike ose ushtrojnë funksione shtetërore, përveç rasteve kur të drejta të tjera themelore, si e drejta e tyre për jetën ose e drejta e tyre për integritet fizik e mendor kërkojnë mbrojtjen e të dhënave të tyre në një rast ose kategori të caktuar rastesh”.

Sa më sipër, është vetë kushtetutëbërësi dhe legjislatori ai i cili ka kryer vlerësimin e përgjithshëm në përputhje me parimin e proporcionalitetit, për të garantuar balancën ndërmjet së drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale dhe interesave legjitime të punonjësve publikë. Në këtë kuptim aksesit në informacion publik për persona që ushtrojnë funksione shtetërore në kuadër të veprimtarisë e tyre nuk pengohet nga e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në lidhje me argumentin se nuk është e nevojshme dhe e domosdoshme vënia në dispozicion e emrave të anëtarëve të grupit të punës, theksojmë se për këtë vlerësim do të duhej që kërkuesi të shpjegonte motivet/interesin për marrjen e informacionit, në mënyrë që të çmohet nëse informacioni është i nevojshëm apo jo për kërkuenin. Megjithatë ankuesi e ka vetëdeklaruar nevojën/interesin për marrjen e informacionit, për shqyrtimin e kësaj ankese interesi i tij është i parëndësishëm në kushtet kur nga pika 2 e nenit 3 të LDI parashikohet se çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet. Si rrjedhojë, e drejta për informim nuk kushtëzohet nga detyrimi i ankuesit për të provuar interesin, domosdoshmërinë ose qëllimin për të cilin kërkohet informacioni, por ushtrohet si një e drejtë autonome, e cila mund të kufizohet vetëm në rastet e parashikuara shprehimisht nga ligji.

Fakti që anëtarët e grupit të punës kanë ushtruar funksionin e tyre në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik dhe kanë përmbushur detyrimet për deklarimin e konfliktit të interesit nuk përbën shkak për kufizimin e së drejtës për informim sipas nenit 17 të LDI. Përkundrazi, transparenca mbi identitetin e personave që kanë marrë pjesë në hartimin e specifikimeve teknike i shërben pikërisht mundësisë për verifikimin publik të respektimit të rregullave mbi paanshmërinë, konfliktin e interesit dhe ligjshmërinë e procesit administrativ.

Argumenti se anëtarët e grupit të punës janë specialistë që angazhohen vazhdimisht në procedura prokurimi nuk përbën shkak për kufizimin e së drejtës për informim. Përkundrazi, sa më i madh të jetë roli i një nëpunësi në procedurat që lidhen me përdorimin e fondeve publike, aq më i lartë është standardi i transparencës dhe llogaridhënies që duhet të zbatohet ndaj tij.

Sa i takon argumentit se ekspozimi i identitetit të tyre krijon një rrezik të arsyeshëm për ushtrimin e presioneve, ndikimeve apo ndërhyrjeve të paligjshme nga subjekte të tretë, mund të cenojë integritetin e procesit administrativ të prokurimit publik, ushtrimin e pavarur dhe të paanshëm të funksioneve të tyre institucionale, si dhe vendosjes në

dispozicion të dokumentacionit pas anonimizimit të të dhënave personale të anëtarëve të grupit të punës, vlerësojmë se ky argument nuk gjen mbështetje në legjislacionin në fuqi.

Ritheksojmë se kufizimi i aksesit në informacion kryhet sipas rasteve të parashikuara nga neni 17 i LDI dhe vlerësimit individual të tyre rast pas rasti. Në rastin në shqyrtim Q.S.U.N.T nuk ka paraqitur një analizë të mirëfilltë apo argumente se si dhe pse kjo e drejtë duhet të kufizohet, kur është e domosdoshme, proporcionale, si dhe dëmin që mund t'u shkaktojë nëpunësve si pasojë e dhënies së informacionit të kërkuar. Ky pretendim është ngritur vetëm në mënyrë hipotetike dhe abstrakte, pa identifikuar një rrezik konkret, aktual dhe të provueshëm, si dhe pa paraqitur prova që vënia në dispozicion e informacionit do të sillte një pasojë reale dhe të drejtpërdrejtë për interesat e mbrojtura nga ligji. Për më tepër, nga ana e Q.S.U.N.T nuk është marrë parasysh se të dhënat e kërkuara, si emrat dhe pozicionet e punës së nëpunësve civilë përbëjnë informacion publik sipas legjislacionit në fuqi dhe praktikës së konsoliduar të Komisionerit.

Sipas parimit të proporcionalitetit dhe testit të dëmit, kufizimi i së drejtës për informim mund të justifikohet vetëm kur autoriteti publik provon se ekziston një dëm konkret, serioz dhe i parashikueshëm ndaj një interesi të ligjshëm të parashikuar nga neni 17 i LDI. Frika e përgjithshme për mundësinë e ushtrimit të ndikimeve ose presioneve në të ardhmen nuk përbën bazë të mjaftueshme ligjore për të kufizuar të drejtën kushtetuese për informim. Ky shkak për kufizimin e së drejtës për informim i paraqitur nga ana e Autoritetit Publik nuk parashikohet as në nenin 17 të LDI, i cili parashikon rastet e kufizimit të informacionit publik, dhe as në ndonjë dispozitë ligjore të legjislacionit të posaçëm.

Kuadri rregullator shqiptar ka parashikuar mjaftueshëm instrumente të tjerë ligjorë për të garantuar zbatimin e detyrave në mënyrë të ligjshme nga zyrtari publik gjatë ushtrimit të funksionit të tij. Për rrjedhojë prezumohen të njohura/ditura të gjitha dispozitat në legjislacionet respektive përpara çdo vendimmarrje sipas fushës përkatëse. Legjislacioni për statusin e nëpunësit civil, konfliktin e interesit, si dhe korpusi i legjislacionit në fuqi për adresimin e rreziqeve të sipërcituara, si dhe legjislacioni penal, parashikojnë mekanizma të posaçëm për mbrojtjen e integritetit të nëpunësve publikë dhe nuk autorizojnë kufizimin e së drejtës për informim si mjet për të shmangur rreziqe hipotetike. Pra, legjislacioni në fuqi parashikon mjete të përshtatshme për adresimin e rreziqeve të sipërcituara, qofshin ato mjete administrative apo kallëzime penale ndaj personave përkatës, kur është rasti.

Po ashtu, funksioni i anëtarëve të grupit të punës lidhet me administrimin e fondeve publike dhe me përgatitjen e dokumenteve që ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik. Për këtë arsye, ekziston një interes i lartë publik për njohjen e identitetit të personave që marrin pjesë në këto procese, me qëllim garantimin e integritetit, transparencës dhe besimit të publikut në administrimin e burimeve publike.

Nëse do të pranohej argumenti i autoritetit publik se emrat e personave të përfshirë në procedurat e prokurimit mund të mbahen të fshehtë për shkak të rrezikut potencial të ndikimit ndaj, atëherë një pjesë e konsiderueshme e veprimtarisë administrative do të

zhvillohej pa transparencë dhe pa mundësi kontrolli publik. Një interpretim i tillë do të ishte në kundërshtim me parimet e shtetit të së drejtës, si dhe me qëllimin dhe objektin e LDI.

Në këto kushte refuzimi i autoritetit publik për të vënë në dispozicion emrat e anëtarëve të grupit të punës nuk mbështetet në një nga kufizimet e parashikuara nga LDI, nuk përmbush kriteret e testit të dëmit dhe as të testit të interesit publik. Kufizimet e së drejtës për informim nuk mund të krijohen përmes interpretimit të zgjeruar të ligjit ose mbi bazën e vlerësimeve të përgjithshme.

Për rrjedhojë, në mungesë të një dispozite të posaçme ligjore për të legjitimuar diskrecionin e Autoritetit Publik, për të kufizuar të drejtën për informim, nëpërmjet parashikimeve të klauzolave kufizuese dhe përjashtuese, Komisioneri vlerëson se ekzistenca e informacionit/dokumentacionit, pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoritetet Publike, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Në përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike. Bazuar në pikën 3, të nenit 3 të LDI, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 913 prot., datë 31.03.2026, të Health and Light sh.p.k, përfaqësuar nga z. (në vijim “ankuesi”) kundër Autoriteteve Publike “Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a dhe Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, (në vijim “Autoritetet Publike”), me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”*.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas pikave 2 dhe 3 të kërkesës për informacion datë 19.03.2026, konkretisht: të gjithë praktikën përkatëse shkresore

ndërmjet O.B.P. sh. a. dhe Q.S.U. “Nënë Tereza”, si dhe kopje të Grupit të Punës/urdhrit për hartimin e specifikimeve teknike, brenda datës 23.06.2026.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 15.06.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi